



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0240

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani dhe Batisha Ibrahim - Anetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) LIMITPROJECT SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Punë për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për konservimin dhe restaurimin e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, në Prishtinë, në Republikën e Kosovës. me numër të prokurimit 207-25-7189-5-1-1, me 04/06/2026, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE LIMITPROJECT SH.P.K. me nr. 2026/0240 , e datës 15/04/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit Punë për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për konservimin dhe restaurimin e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, në Prishtinë, në Republikën e Kosovës. me numër të prokurimit 207-25-7189-5-1-1.
2. **Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, ndërkaq aktiviteti i prokurimit Punë për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për konservimin dhe restaurimin e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, në Prishtinë, në Republikën e Kosovës. me numër të prokurimit 207-25-7189-5-1-1 kthehet në **Rivlerësim**.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik LIMITPROJECT SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 07.08.2025 MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit, “Pune per zbatimin e projektit te hollesishem [zbatues kryesor], te arkitektures dhe inxhinierise, per konservimin dhe restaurimin e Bibliotekes Kombetare te Kosoves, ne Prishtine, ne Republiken e Kosoves.” me nr. të prokurimit: "207-25-7189-5-1-1

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: shërbim, vlera e parashikuar e kontrates: 22,000,000 €

Me 02.02.2026 MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), kunder anulimit te aktivitetit.

Me 03.04.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 14.04.2026. AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 15.04.2026 LIMITPROJECT SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0240, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, kunder anulimit te aktivitetit.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues LIMITPROJECT SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Legjislacioni primar:

A.

Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Specifikisht të neneve:

Neni 7. Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi

Neni 10. Mjetet për promovimin e Transparencës

Neni 59. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60. Kriteret për dhënie të Kontratës

Neni 72. Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Legjislacioni sekondar:

B. A01. Rregullore Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Specifikisht të neneve:

Neni 40. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

C. A02. Udhëzues Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik

Specifikisht të dispozitave:

Dispozitat e përgjithshme

Qëllimi dhe Fushëveprimi i Udhëzuesit Operativ për Prokurim

Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

Në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (LPP), i ndryshuar dhe plotësuar, si dhe në përputhje me Udhëzuesit Administrativ të nxjerrë nga KRPP, Grupi i Operatorëve Ekonomikë (GOE) paraqet këtë ankesë ndaj vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK) për eliminimin e ofertës, vendim ky i cili është i pabazuar ligjërisht, i paarsyetuar drejt dhe në kundërshtim me Dosjen e Tenderit, LPP-në dhe Udhëzuesit Administrativ përkatës.

GOE është ofertuesi i vetëm në këtë procedurë prokurimi, fakt ky që sipas nenit 7 të LPP-së (Parimet e Prokurimit Publik) e obligon AK-në që ofertën ta vlerësojë në mënyrë objektive, proporcionale dhe substanciale, duke shmangur refuzimet formale dhe interpretimet e zgjeruara që nuk burojnë nga kriteret e përcaktuara paraprakisht.

Qëllimi i Ligjit për Prokurimin Publik – Neni 1:

Në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, qëllimi i këtij ligji është të sigurojë përdorim efikas, transparent dhe racional të fondeve publike, si dhe realizimin e kontratave publike nëpërmjet konkurrencës së drejtë dhe vlerësimit objektiv të ofertave.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues, duke eliminuar ofertën e vetme të paraqitur në procedurë mbi baza formale dhe interpretime që nuk burojnë nga Dosja e Tenderit, ka vepruar në kundërshtim me qëllimin themelor të Ligjit për Prokurimin Publik. Një veprim i tillë nuk i shërben realizimit të kontratës publike, por përkundrazi e pengon atë, duke cenuar efikasitetin e procedurës dhe përdorimin racional të fondeve publike.

Eliminimi i ofertës së vetme, në rrethana kur Operatori Ekonomik ka përmbushur kërkesat substanciale të Dosjes së Tenderit, përbën zbatim formalist të ligjit dhe devijim nga qëllimi i nenit 1 të LPP-së, i cili kërkon që procedurat e prokurimit të çojnë në nënshkrimin dhe realizimin e kontratave publike, e jo në anulime apo refuzime të pajustificuara.

PRETENDIMI

Autoriteti Kontraktues në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar ka theksuar këtë arsye që jemi administrativisht të papërgjegjshëm:

Pas vlerësimit të ofertës, komisioni ka konstatuar se operatori ekonomik nuk e ka plotësuar kërkesën nr. 2 të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar të paraqitur nga AK në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, citat:

“Kërkesa numër 2. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të gjendjes ekonomike dhe kapacitetit financiar për të përmbushur kërkesat e lëndës së kësaj procedure; dhe për këtë qëllim, duhet të dëshmojë se disponon me kapital të mjaftueshëm për zbatimin e kontratës, qoftë mjete të gatshme në llogarinë bankare OSE qasje në një kredi bankare, të pakushtëzuar në emër të këtij projekti, përkatësisht në emër të këtij aktiviteti të prokurimit, në shumën si në vijim – 2,000,000.00 € [Dy milion euro]; ndërsa si dëshmi është kërkuar nga AK, citat:

Dëshmia e kërkuar dokumentare – Një [1] vërtetim nga një bankë e klasës së parë, i cili dëshmon se Operatori Ekonomik disponon me mjete të gatshme në llogarinë bankare, në shumën e përcaktuar më lartë [Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomikë, udhëheqësi (‘leader’) i Grupit duhet të përmbushë së paku 60.00% të kësaj kërkesë] – Një [1] kopje e origjinalit.

OSE – Një [1] vërtetim nga një bankë e klasës së parë, i cili dëshmon se Operatori Ekonomik disponon me qasje në një kredi bankare të pakushtëzuar në emër të këtij projekti, në shumën e përcaktuar më lartë [Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomikë, udhëheqësi (‘leader’) i Grupit duhet të përmbushë së paku 60.00% të kësaj kërkesë] – Një [1] kopje e origjinalit.”

Operatori Ekonomik për këtë kërkesë ka ofruar dëshmi nga banka – LETËR PËRKRAHJE, citat:

“Që nëse kompania Limit Project SH.P.K shpërblehet me kontratë nga AK – MKRS, për kontratën me titull: ‘Punë për zbatimin e projektit të hollësishëm [zbatues kryesor], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për konservimin dhe restaurimin e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, në Prishtinë, në Republikën e Kosovës’, me numër prokurimi: 207-25-7189-5-1-1 dhe me numër të brendshëm të prokurimit: 207-25-088-5-1-1, NLB Banka Sh.A. do ta mbështesë financiarisht në shumën deri në EUR 2,000,000.00 (Dy milion euro).”

Sipas komisionit të vlerësimit, kërkesa e AK-së është që në momentin e aplikimit OE duhet të dorëzojë tek AK një vërtetim nga banka që disponon mjete të gatshme në llogarinë bankare në shumën e përcaktuar nga AK ose OE duhet të dorëzojë tek AK një vërtetim nga banka që disponon me qasje në një kredi bankare të pakushtëzuar në emër të këtij projekti, në shumën e përcaktuar nga AK.

Në rastin tonë, GOE e ka ofruar dëshminë nga banka – LETËR PËRKRAHJE që dëshmon se OE do të mbështetet financiarisht nga institucioni bankar në rastin kur kompania shpërblehet me kontratë, andaj si dëshmi është e papranueshme për AK sepse nuk tregon se GOE ka mjete të gatshme në bankë ose limit kreditor të aprovuar për realizimin e këtij projekti.

Po ashtu, pas vlerësimit të ofertës së GOE është konstatuar se kërkesa me nr. 3 të Kapacitetit Teknik dhe/ose Profesional, citat:

“Kërkesa numër 3. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kompetencës dhe përvojës së mjaftueshme në sektorin përkatës dhe për këtë qëllim duhet të dëshmojë se gjatë tre [3] viteve të shkuara, ka zbatuar kontrata [gjithnjë në mënyrë të rregullt dhe ligjshme] si në vijim:

[a.] Punë për zbatimin e projekteve të hollësishme [zbatuese kryesore], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për konservimin dhe restaurimin e aseteve të trashëgimisë kulturore [të cilat janë pjesë e listës zyrtare të aseteve të mbrojtura të regjistruara të trashëgimisë kulturore], në shumë prej së paku 5,000,000.00 € [Pesë milion euro]; dhe

[b.] Punë për zbatimin e projekteve të hollësishme [zbatuese kryesore], të arkitekturës dhe inxhinierisë, për ndërtimin dhe/ose renovimin e ndërtesave publike/shoqërore [sipas përkufizimit të paraqitur në vijim], në shumë prej së paku 10,000,000.00 € [Dhjetë milion euro];

ndërsa si dëshmi është kërkuar nga AK, citat:

Dëshmitë për kërkesën nr. 3: Licencë profesionale – Kategoria B2 për zbatimin e punëve të konservimit dhe restaurimit të trashëgimisë kulturore të paluajtshme, OSE Vendimi i Bordit për dhënie të licencës profesionale për kategorinë B2 për zbatimin e punëve të konservimit dhe restaurimit të trashëgimisë kulturore të paluajtshme, për person juridik [Lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit] – Një [1] kopje e origjinalit.

Vërejtje – Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomikë, udhëheqësi (‘leader-i’) i Grupit dhe të gjithë anëtarët e Grupit duhet të përmbushin këtë kërkesë.”

Grupi i Operatorëve Ekonomikë nuk e plotëson, sepse dëshmitë e ofruara nuk e arrijnë vlerën financiare sipas kërkesës së AK-së.

GOE ka ofruar 4 lista të projekteve të realizuara. Projektet e ofruara në listat e GOE janë projekte të përsëritura tek tri listat e projekteve të dorëzuara nga Operatorët Ekonomikë LIMIT PROJECT SH.P.K., RINESA SH.P.K. dhe DELTA-CCD SH.P.K.

Meqenëse lideri i GOE është OE LIMIT PROJECT SH.P.K., të gjitha projektet e realizuara të natyrës së ngjashme të cilat gjenden në tri listat e projekteve të ofruara i janë përlllogaritur vetëm liderit të grupit dhe pas llogaritjes së vlerës financiare të të gjitha projekteve të paraqitura në listat e projekteve është konstatuar se GOE nuk e arrin vlerën financiare të kërkuar nga AK.

REFUZIMI PËR PËRVOJËN E PUNËVE TË KRYERA

2.1 Kriteri i Dosjes së Tenderit dhe Udhëzuesit Administrativ për GOE

Dosja e Tenderit ka kërkuar shprehimisht që lideri i grupit të ketë së paku 60% të vlerës së punimeve të kryera.

Sipas Udhëzuesit Administrativ për Prokurimin Publik – pjesa që rregullon Grupet e Operatorëve Ekonomikë – kapacitetet profesionale dhe ekonomike mund të plotësohen në mënyrë kumulative, përderisa kriteri kryesor i përcaktuar në Dosjen e Tenderit (në këtë rast 60% për liderin) është i përmbushur.

Kërkesa nr. 3 e Dosjes së Tenderit përcakton shprehimisht se Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë përvojë në zbatimin e kontratave gjatë tre (3) viteve të fundit, përkatësisht:

[a.] Punë në projekte të arkitekturës dhe inxhinierisë për konservimin dhe restaurimin e aseteve të trashëgimisë kulturore në vlerë prej së paku 5,000,000.00 €, dhe

[b.] Punë në projekte të arkitekturës dhe inxhinierisë për ndërtimin dhe/ose renovimin e ndërtesave publike/shoqërore në vlerë prej së paku 10,000,000.00 €.

Po ashtu, në pjesën e dëshmisë dokumentare, Dosja e Tenderit përcakton qartë se në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomikë, udhëheqësi ('leader') i Grupit duhet të përmbushë së paku 60.00% të kësaj kërkesë.

2.2 Arsyetimi i AK-së dhe harmonizimi faktik

AK ka arsyetuar eliminimin duke pretenduar se:

“Projektet janë të përsëritura ndërmjet anëtarëve të GOE-së dhe vlera financiare nuk është e ndarë sipas pjesëmarrjes reale.”

Ky pretendim është faktikisht i pasaktë, pasi:

projektet janë paraqitur ndaras për secilën kompani;

nuk ka kontrata të njëjta të llogaritura dy ose më shumë herë;

lideri i grupit mbulon vetë dhe i vetëm mbi 60% të vlerës së kërkuar.

Dosja e Tenderit dhe Udhëzuesi Administrativ nuk parashikojnë ndalim për paraqitjen e projekteve të njëjta, për aq kohë sa nuk ka llogaritje të dyfishtë të vlerës financiare.

Në këtë procedurë, lideri i GOE-së, LIMIT PROJECT SH.P.K., jo vetëm që përmbush kërkesën minimale prej 60%, por i vetëm e arrin dhe e tejkalon vlerën e kërkuar të punëve të kryera sipas pikave [a] dhe [b] të Kërkesës nr. 3, bazuar në listat e punëve të kryera dhe dëshmitë përkatëse të dorëzuara në ofertë. Për rrjedhojë, kriteri i Dosjes së Tenderit është përmbushur plotësisht vetëm nga lideri i GOE-së.

Në kundërshtim me këtë dispozitë të qartë, Autoriteti Kontraktues ka:

reduktuar në mënyrë të pabazuar numrin e listave të punëve të kryera të dorëzuara nga GOE;

paraqitur një llogaritje financiare të gabuar duke pretenduar se lideri i GOE-së nuk e arrin pragun e kërkuar.

Në vijim, po ju prezantojmë totalët e punëve të kryera për secilin OE pjesë e GOE në këtë procedurë:

a) LIMIT PROJECT SH.P.K. – trashëgimi: 6,439,308.36 €

b) LIMIT PROJECT SH.P.K. – punë në ndërtim dhe renovim: 8,430,939.52 €

c) RINESA SH.P.K. – 3,429,385.35 €

d) DELTA-CCD SH.P.K. – 4,053,165.98 €

e) ALPING Sh.P.K. – 2,733,911.66 €

Totali: 25,086,710.87 €

Lista e punëve të kryera për LIMIT PROJECT SH.P.K. është ndarë për të argumentuar se i vetëm LIMIT PROJECT SH.P.K. e plotëson kriterin 3 – pika [a], punë në projekte të arkitekturës dhe inxhinierisë për konservimin dhe restaurimin e aseteve të trashëgimisë kulturore në vlerë prej së paku 5,000,000.00 €, dhe se ka më shumë se 80% të pikës [b] – punë në projekte të arkitekturës dhe inxhinierisë për ndërtimin dhe/ose renovimin e ndërtesave publike/shoqërore në vlerë prej së paku 10,000,000.00 €.

Bashkëngjitur: Sqarimi i listës së punëve të kryera me pranime teknike ose referenca të punëve, dëshmuar me listën e dorëzuar në AK.

Po ashtu, po ju bashkëngjesim sqarimin e listës së punëve të përfunduara sipas situacioneve të dorëzuara para datës së njoftimit për kontratë, konform nenit 72 të LPP-së:

a) RINESA SH.P.K. – 2,113,410.55 €

b) DELTA-CCD SH.P.K. – 1,157,575.65 €

c) ALPING Sh.P.K. – 3,558,542.21 €

Totali: 6,829,528.41 €

Dëshmi shtesë për punët e kryera paraqesim edhe fotot për objektet të cilat janë ndërtuar në kuadër të sheshit Drenas dhe Bulevardit Vushtrri, që argumentojnë se objektet në fjalë janë ndërtim i lartë – publik.

AK ka bërë një shkelje flagrante duke mos e pranuar si projekt të trashëgimisë kontratën me Autoritetin Kontraktues – KK Prizren, me vlerë mbi 2.8 milion euro.

Ky është vetëm njëri nga shembujt e shkeljeve në vlerësim. Ju bashkëngjesim dokumentin që dëshmon se ky aset është pjesë e trashëgimisë kulturore.

Po ashtu, ndarja e vlerave sipas përqindjeve (nuk e dimë si e kanë bërë ndarjen e vlerave AK – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit), është e pavend dhe e pabazuar në LPP.

2.3 Shkeljet ligjore të AK-së

Me këtë interpretim, AK ka shkelur:

nenin 71 të LPP-së (Grupet e Operatorëve Ekonomikë),

nenin 59 dhe 60 të LPP-së,

nenin 7 të LPP-së,

duke interpretuar kriteret në mënyrë kufizuese dhe jashtë Dosjes së Tenderit.

PRETENDIM I THELLUAR PËR RRËZIMIN E VENDIMIT TË AUTORITETIT KONTRAKTUES

Vendimi i Autoritetit Kontraktues për eliminimin e Operatorit Ekonomik dhe anulimin e aktivitetit të prokurimit është i kundërligjshëm, arbitrar dhe i mbështetur në një vlerësim të deformuar të fakteve dhe kriterëve të Dosjes së Tenderit.

Ky vendim nuk përfaqëson një ushtrim të ligjshëm të diskrecionit administrativ, por një devijim të qartë nga dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe parimet themelore të tij.

I. PARAQITJE E PËRMBUSHJES SË KRITERIT TË KAPACITETIT TEKNIK DHE PROFESIONAL

Operatori Ekonomik thekson se oferta e dorëzuar përmbush në tërësi kërkesat e Dosjes së Tenderit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional, përkatësisht kriterin për dëshminë e përvojës në realizimin e punëve të natyrës së ngjashme.

Në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktues, OE ka paraqitur:

lista të detajuara të punëve të kryera, të nënshkruara dhe të vulosura;

kontrata dhe certifikata të pranimi teknik;

si dhe dëshmi të tjera relevante që vërtetojnë realizimin e projekteve përkatëse.

Këto dokumente dëshmojnë qartë se OE ka realizuar punë në fushën e kërkuar, duke përfshirë projekte të konservimit dhe restaurimit të aseteve të trashëgimisë kulturore, si dhe ndërtim dhe renovim të objekteve publike/shoqërore, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

II. NATYRA E REFERENCAVE – PUNË TË KRYERA DHE TË DËSHMUARA

Referencat e paraqitura nga OE përfaqësojnë punë reale të kryera, të mbështetura me dokumentacion zyrtar, duke përfshirë:

kontrata të realizuara;

raporte të pranimi teknik;

dhe dëshmi të tjera që konfirmojnë përfundimin e punimeve.

Përvoja e paraqitur është konkrete, e verifikueshme dhe në përputhje të plotë me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

III. PËRMBUSHJA E KRITERIT NGA GRUPI I OPERATORËVE EKONOMIKË

Në rastin e pjesëmarrjes si Grup i Operatorëve Ekonomikë, kriteri i përvojës është përmbushur nga grupi si tërësi, në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Lideri i grupit përmbush nivelin e kërkuar të përfshirjes në këtë kriter, ndërsa referencat e anëtarëve të tjerë plotësojnë dhe forcojnë kapacitetin e përgjithshëm të grupit.

Referencat janë komplementare dhe dëshmojnë kapacitet të plotë për realizimin e kontratës.

IV. SHKELJET E AUTORITETIT KONTRAKTUES NË VLERËSIM

Pavarësisht përmbushjes së qartë të kriterit nga ana e OE, Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar një proces vlerësimi të kundërligjshëm, të njëanshëm dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Devijimi nga kriteri i Dosjes së Tenderit

Autoriteti Kontraktues ka interpretuar kriterin në mënyrë të gabuar, duke e trajtuar atë si kriter për “kontrata të përfunduara”, ndërkohë që kërkesa është për “punë të kryera”.

Ky ndryshim i kriterit pas hapjes së ofertave përbën shkelje të nenit 7 dhe nenit 59 të LPP-së.

Llogaritje të pasakta dhe selektive

Autoriteti Kontraktues ka kryer llogaritje të pasakta dhe jo-konsistente të vlerave të punëve të realizuara, duke mos reflektuar saktë dokumentacionin e paraqitur.

Nga vetë vendimi i Autoritetit Kontraktues shihet qartë se vlerësimi është ndërtuar mbi një përpunim të fragmentuar dhe jo objektiv të të dhënave.

Mosmarrja në konsideratë e referencave relevante

Autoriteti Kontraktues nuk ka marrë në shqyrtim të gjitha referencat e dorëzuara, duke përjashtuar projekte që dëshmojnë qartë përmbushjen e kriterit.

Ky veprim përbën shkelje të nenit 59 të LPP-së dhe cenon rëndë parimin e vlerësimit të plotë dhe objektiv.

Rivlerësim formal dhe jo real

Pas kthimit në rivlerësim, Autoriteti Kontraktues nuk ka reflektuar në mënyrë reale, por ka riprodhuar të njëjtat gabime, duke e bërë rivlerësimin formal dhe jo efektiv, përkundër se ka aprovuar si të bazuar kërkesën për rishqyrtim të datës 03.02.2026.

Vonesë e pajustificuar dhe joproporcionale

Zgjatja e procedurës së rivlerësimit për më shumë se 50 ditë, në një rast me vetëm një ofertues, përbën shkelje të parimeve të efikasitetit dhe transparencës.

Anulim i kundërligjshëm i procedurës

Konkludimi se nuk ka oferta të përgjegjshme është i pabazuar dhe rrjedh nga një vlerësim i gabuar dhe i njëanshëm.

Mosrespektimi i vendimit të mëparshëm për aprovimin e kërkesës për rishqyrtim dhe rivlerësim i njëanshëm

Është me rëndësi thelbësore të theksohet se për të njëjtën pikë kontestuese, Autoriteti Kontraktues ka eliminuar Operatorin Ekonomik si në vendimin fillestar, ashtu edhe në vendimin pas rivlerësimit.

Gjithashtu, në vendimin e parë, OE është eliminuar edhe për një pikë shtesë lidhur me mbështetjen bankare, për të cilën, pas kërkesës për rishqyrtim, vetë Autoriteti Kontraktues ka

konstatuar se pretendimi ynë është i bazuar dhe ka vendosur kthimin e lëndës në rivlerësim.

Pra, Autoriteti Kontraktues:

ka pranuar se vlerësimi fillestar ka qenë i gabuar;

ka kthyer lëndën në rivlerësim për korrigjim të këtyre gabimeve;

dhe ka qenë i obliguar që gjatë rivlerësimit të veprojë në përputhje me këto konstatime.

Megjithatë, në kundërshtim me këtë:

Autoriteti Kontraktues ka ripërsëritur të njëjtin eliminim për të njëjtën pikë;

pa ofruar analizë të re substanciale;

dhe pa reflektuar në vendimin e mëparshëm.

Kjo dëshmon qartë se rivlerësimi nuk ka qenë real, por formal dhe me rezultat të parapërcaktuar.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues ka mbajtur lëndën në rivlerësim për afatin maksimal të lejuar, pavarësisht se çështjet kontestuese kanë qenë të kufizuara dhe tashmë të trajtuara.

Kjo sjellje:

cenon parimin e paanshmërisë;

bie ndesh me parimin e efikasitetit;

dhe krijon dyshim të bazuar për qëllim të zvarritjes së procedurës dhe justifikimit të një vendimi të njëjtë – eliminimit të OE dhe anulimit të procedurës.

V. PËRFUNDIM DHE KËRKESË

Duke u bazuar në të gjitha argumentet e sipërcekura, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik që:

të anulojë vendimin për eliminimin e Operatorit Ekonomik;

të anulojë vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit;

dhe të kthejë lëndën në rivlerësim të drejtë, të plotë dhe në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik

Përgjigja në kërkesën për rishqyrtim:

Refuzohet pretendimi ankimor si i pabazuar:

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka analizuar në detaje pretendimin ankimor të paraqitur nga Limit Project SHPK lidhur me konstatimin se nuk plotësohet Kërkesa nr. 3. Sipas kësaj kërkesë, operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kompetencës dhe përvojës së mjaftueshme në sektorin përkatës dhe, për këtë qëllim, duhet të dëshmojë se gjatë tre (3) viteve të fundit ka zbatuar kontrata në mënyrë të rregullt dhe ligjshme si vijon:

a) Punë për zbatimin e projekteve të hollësishme (zbatuese kryesore) të arkitekturës dhe inxhinierisë për konservimin dhe restaurimin e aseteve të trashëgimisë kulturore, të cilat janë pjesë e listës zyrtare të aseteve të mbrojtura të regjistruara të trashëgimisë kulturore, në vlerë së paku 5,000,000.00 €; dhe

b) Punë për zbatimin e projekteve të hollësishme (zbatuese kryesore) të arkitekturës dhe inxhinierisë për ndërtimin dhe/ose renovimin e ndërtesave publike shoqërore në vlerë së paku 10,000,000.00 €.

Bazuar në të dhënat në sistem, është konstatuar se Grupi i Operatorëve Ekonomikë aplikues (Limit Project SHPK, Rinesa SHPK, Delta CCD SHPK dhe ALPING SHPK) nuk e plotëson kriterin nr. 3, pasi referencat për objektet e trashëgimisë kulturore arrijnë në 4,925,546.61 € (ndërkohë që kërkohen 5,000,000.00 €), ndërsa referencat për ndërtim arrijnë në 6,651,495.40 € (ndërkohë që kërkohen 10,000,000.00 €). Pra, në total janë paraqitur referenca në vlerë 11,577,042.01 €, ndërsa kërkohen 15,000,000.00 € (me ndarjen 5+10).

Sipas operatorëve ekonomikë në kuadër të GOE:

Limit Project SHPK: 2,606,386.98 € (trashëgimi) dhe 2,762,771.58 € (ndërtim)

Rinesa SHPK: 1,345,207.00 € (trashëgimi) dhe 420,802.91 € (ndërtim)

Delta CCD SHPK: 768,233.44 € (trashëgimi) dhe 446,671.39 € (ndërtim)

ALPING SHPK: 205,719.25 € (trashëgimi) dhe 2,528,192.41 € (ndërtim)

Totali: 4,925,546.61 € (trashëgimi) dhe 6,651,495.40 € (ndërtim), përkatësisht 11,577,042.01 € gjithsej.

Nga lista e paraqitur për punët e kryera rezulton se Limit Project SHPK ka mbi 25 kontrata që janë ose ende në vazhdim, ose kanë skaduar para datës së aplikimit (më shumë se 3 vite para datës së hapjes së procedurës). Situata e njëjtë konstatohet edhe për Delta CCD SHPK, Rinesa SHPK dhe ALPING SHPK. Për rrjedhojë, Grupi i Operatorëve Ekonomikë nuk i plotëson referencat e kërkuara.

Gjithashtu, gjatë kërkesës për rishqyrtim, GOE nuk ka ngritur asnjë pretendim konkret lidhur me arsyetimin e eliminimit dhe tabelën e referencave të paraqitura më lart, duke mos paraqitur fakte dhe argumente që dëshmojnë përmbushjen ose tejkalimin e kriterëve. Kërkesa e paraqitur është e përgjithshme dhe pa prova konkrete që dëshmojnë referenca të natyrës së ngjashme. Pretendimi se posedohen referenca mbi 25 milionë euro nuk qëndron, pasi disa projekte kanë kaluar afatin 3-vjeçar, disa nuk janë sipas kërkesës “një kopje e origjinalit”, ndërsa disa janë ende në zbatim.

Sqarim: “Ndërtesa publike shoqërore” në këtë aktivitet prokurimi përfshin të gjitha tipologjitë e ndërtesave të sportit, kulturës, arsimit, shëndetësisë dhe administratës (nën administrim pronësi shtetërore – lokale ose qendrore, brenda dhe jashtë Kosovës, si dhe nën administrim të shteteve të tjera ose organizatave ndërkombëtare), ndërsa përjashton tipologjitë e tjera.

Është konstatuar gjithashtu se në disa raste një kontratë është paraqitur dy herë (një herë si kontratë bazë dhe një herë e ndarë në lote), duke rezultuar në dyfishim të vlerave financiare (rastet e projekteve 42, 43 dhe 44 me vlerë të dyfishuar 455,994.84 €). Po ashtu, te ALPING

SHPK projektet 3, 4, 7, 12 dhe 13 janë ende në zbatim. Për këto arsye, pretendimi ankimor refuzohet si i pabazuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 16.04.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0240, ndërsa me datë 28.04.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0240, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e LIMITPROJECT SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/00240 ka vlerësuar si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Pretendimi nr. 1

Pretendimi i parë ankimor ka të bëjë me arsyen e AK-së për eliminim të OE ankues, ku sipas AK-së i njëjti nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit për para të gatshme ose qasje në kredi të pakushtëzuar në emër të këtij projekti.

Me rastin e kërkesës së parë për rishqyrtim (e aprovuar pjesërisht nga AK), OE ankues ka potencuar se:

“ Sipas Udhëzuesit Administrativ për Prokurimin Publik (KRPP), pjesa që rregullon Kapacitetin Ekonomik dhe Financiar, dëshmia për qasje në kredi bankare mund të ofrohet përmes:

vërtetimit bankar,

letrës përkrahëse bankare,

ose dokumenteve të tjera ekuivalente që vërtetojnë disponueshmërinë e mjeteve financiare.

Ky arsyetim nuk qëndron dhe bie ndesh drejtpërdrejt me kriterin e Dosjes së Tenderit dhe Udhëzuesit Administrativ, pasi:

çdo financim bankar për kontrata publike aktivizohet vetëm pas fitimit të kontratës;

Dosja e Tenderit nuk ka kërkuar kredi të disbursuar, por vetëm dëshmi për qasje në kredi;

Udhëzuesi Administrativ e pranon shprehimisht letrën e përkrahjes bankare si dokument të vlefshëm.

Duke mos e konsumuar nenin 59 të LPP-së, sqarimi i dosjes së tenderit, keni mundur të kërkonit sqarim/konfirmim nga banka lidhur me këtë dokument dhe do të kuptonit se banka ka dhënë një konfirmim për qasje të pakushtëzuar në kredi për këtë projekt, ku edhe ka theksuar titullin e tenderit dhe numrin e prokurimit.

Prandaj, ju keni vepruar në kundërshtim me LPP.

1.3 Shkeljet ligjore të AK-së lidhur me këtë pretendim:

Me këtë veprim, AK ka shkelur:

nenin 59 të LPP-së (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave),

nenin 60 të LPP-së (Kriteret për dhënien e kontratës),

nenin 72 të LPP-së (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë),

nenin 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi),

duke vendosur një kriter shtesë që nuk është paraparë në Dosjen e Tenderit dhe as në Udhëzuesin Administrativ”.

OE ankues në ofertë ka bashkëngjitur letër mbështetëse nga banka e cila konfirmon që, nëse Kompania Limit Project SH.P.K. shpërblehet me kontratë nga AK-MKRS, për kontratën me titull: “Punë për zbatimin e projektit të hollësishëm (zbatues kryesor), të arkitekturës dhe inxhinierisë, për konservimin dhe restaurimin e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, në Prishtinë, në Republikën e Kosovës”, me numër të prokurimit: 207-25-7189-5-1-1 dhe me numër të brendshëm të prokurimit: 207-25-088-511, NLB Banka Sh.A. do ta mbështesë financiarisht në shumën deri në EUR 2,000,000.00 (dy milionë euro).

Eksperti shqyrtues jep mendim se mbështetja nga banka është mjaft e qartë se, në rast se OE shpërblehet me kontratë, banka do ta mbështesë financiarisht në shumën prej 2,000,000 €.

Do të thotë, mbështetja nga banka nuk është e kushtëzuar në asnjë formë, siç ndodh shpesh në aktivitete të prokurimit, ku zakonisht kushtëzohet mbështetja me shprehje “në qoftë se klienti plotëson kushtet” ose “pas vlerësimit të organit kompetent” etj.

Në rastin konkret, mbështetja nga banka është e qartë dhe e pakushtëzuar.

Bazuar në këto që u cekën më lart, vlerësojmë se vendimi i AK-së është marrë në kundërshtim me kërkesat e dosjes.

Pretendimi nr. 2

Arsyeja e dytë e eliminimit të OE ankues nga AK-ja lidhet me përvojën e OE-së. AK pretendon se një numër i projekteve të prezantuara janë më të vjetra se tri vitet e kërkuara, se një numër i projekteve/kontratave ende nuk kanë përfunduar dhe se një numër i tyre nuk janë të natyrës përkatëse.

OE ankues, ndër të tjera, pretendon se:

“Dosja e Tenderit ka kërkuar shprehimisht që Lideri i Grupit të ketë së paku 60% të vlerës së punimeve të kryera. Sipas Udhëzuesit Administrativ për Prokurimin Publik – pjesa që rregullon Grupet e Operatorëve Ekonomikë – kapacitetet profesionale dhe ekonomike mund të plotësohen në mënyrë kumulative, përderisa kriteri kryesor i përcaktuar në Dosjen e Tenderit (në këtë rast 60% për liderin) është i përmbushur.

Kërkesa nr. 3 e Dosjes së Tenderit përcakton shprehimisht se Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë përvojë në zbatimin e kontratave gjatë tre (3) viteve të fundit, përkatësisht:

[a] punë në projekte të arkitekturës dhe inxhinierisë për konservimin dhe restaurimin e aseteve të trashëgimisë kulturore në vlerë prej së paku 5,000,000.00 €, dhe

[b] punë në projekte të arkitekturës dhe inxhinierisë për ndërtimin dhe/ose renovimin e ndërtesave publike/shoqërore në vlerë prej së paku 10,000,000.00 €.

Po ashtu, në pjesën e dëshmisë dokumentare, Dosja e Tenderit përcakton qartë se, në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomikë, udhëheqësi (leader) i Grupit duhet të përmbushë së paku 60.00% të kësaj kërkesë.

2.2 Arsytimi i AK-së dhe harmonizimi faktik

AK ka arsyetuar eliminimin duke pretenduar se:

“Projektet janë të përsëritura ndërmjet anëtarëve të GOE-së dhe vlera financiare nuk është e ndarë sipas pjesëmarrjes reale.”

Ky pretendim është faktikisht i pasaktë, pasi:

projektet janë paraqitur ndaras për secilën kompani;

nuk ka kontrata të njëjta të llogaritura dy ose më shumë herë;

Lideri i Grupit mbulon vetë dhe i vetëm mbi 60% të vlerës së kërkuar.

Dosja e Tenderit dhe Udhëzuesi Administrativ nuk parashikojnë ndalim për paraqitjen e projekteve të njëjta, për aq kohë sa nuk ka llogaritje të dyfishtë të vlerës financiare.

Në këtë procedurë, lideri i GOE-së, LIMIT PROJECT SH.P.K., jo vetëm që përmbush kërkesën minimale prej 60%, por i vetëm e arrin dhe e tejkalon vlerën e kërkuar të punëve të kryera sipas pikave [a] dhe [b] të Kërkesës nr. 3, bazuar në listat e punëve të kryera dhe dëshmitë përkatëse të dorëzuara në ofertë.

Për rrjedhojë, kriteri i Dosjes së Tenderit është përmbushur plotësisht vetëm nga lideri i GOE-së.”

Eksperti shqyrtues, sa i përket kontratave më të vjetra se tri vite, fillimisht sqaron se kërkesa e dosjes së tenderit decidivisht ka qenë “gjatë tri viteve të shkuara”.

Në rastin konkret, AK nuk ka përcaktuar afat konkret me datë dhe nuk ka potencuar ndonjë prag si fillim të llogaritjes së kohës/periudhës, siç përdoret zakonisht në dosje të tenderit “nga data e njoftimit për kontratë”.

Në rastin konkret, kërkesa është për kontrata gjatë tri viteve të shkuara.

Me qenë se njoftimi për kontratë është publikuar në vitin 2025, sipas mendimit të ekspertit, tri vitet e shkuara nga viti 2025 janë vitet 2024, 2023 dhe 2022, andaj çdo kontratë e përfunduar nga viti 2022 e tutje duhet të pranohet si e mirëqenë (sipas vetë kërkesës së dosjes).

Po ashtu, sa i përket arsyetimit se OE ka përshkruar kontrata të cilat janë në zbatim e sipër, AK në dosje të tenderit dhe te dëshmia dokumentare në asnjë rast nuk ka kërkuar “kontrata të përfunduara”, megjithatë është kërkuar të dëshmohet se OE ka “zbatuar kontrata” dhe është kërkuar dëshmi për punë në zbatimin e projekteve të hollësishme.

Eksperti jep mendim se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara dhe rekomandon që, me rastin e rivlerësimit, të kërkohen sqarime shtesë dhe të bëhet vlerësim sipas rekomandimit të dhënë më lart dhe në pajtim me kërkesat e dosjes

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Pune per zbatimin e projektit te hollesishem [zbatues kryesor], te arkitektures dhe inxhinierise, per konservimin dhe restaurimin e Bibliotekes Kombetare te Kosoves, ne Prishtine, ne Republiken e Kosoves.” me nr. të prokurimit: "207-25-7189-5-1-1

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrës dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nënpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet

me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E KULTURES RS DHE ÇJK**
- **OE - LIMITPROJECT SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: